

AKT THEMELIMI

I

SHOQERISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

"ASTEROID ENERGY"

Sot, më datë 22/03/2024,

Alexander Schnell shtetas Austriak, i ditëlindjes **07/01/1972**, lindur në Viene, mbajtës i pasaportes nr **U0206852** zotëron 1 kuotë duke përfaqësuar 100% te kapitalit, vendosi të themelojë një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar sipas legjislacionit shqiptar në fuqi dhe në përputhje me të.

NENI 1

Themelimi

Emri i shoqerisë është "**ASTEROID ENERGY**". Në të gjitha aktet që do të nxjerrë shoqëria drejtuar të tretëve dhe jo vetëm, do të shënohet emri "**ASTEROID ENERGY** SHPK".

NENI 2

Qëllimi i krijimit të Shoqerisë

Objektivi i shoqërisë do jetë aktiviteti në fushën e: Konsulencë Binzesa dhe sherbime te tjera per bizneset.

NENI 3

Emri dhe vula e Shoqerisë

Shoqëria del në qarkullim me emrin "**Asteroid Energy**" Sh.p.k dhe kompania do ketë vulën e saj.

NENI 4

Objekti i veprimitarës

Objektivi i shoqërisë do jetë: Konsulencë Binzesi dhe sherbime te tjera per bizneset.

NENI 5

Selia e Shoqerisë dhe Afati

Selia e Shoqërisë ndodhet në adresen: **Ndertesa me nr. Pasurie 1/342-N23, Lagjja Vasil Shanto, Rruga Qemal Draçini, zona kadastrale 8593, Shkoder 4001.**

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një afat kohor të pacaktuar, duke filluar nga dita e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.



30/03/2024

NENI 6

Kapitali i Shoqerisë dhe Ortakët

Kapitali i shoqerisë është në vlerën **50.000** (Pesedhjete mijë) lekë, i ndarë në 1 kuotë ku kuota ka vlerën **50.000** lekë.

Ortaku themelues i Shoqerisë Tregtare me emrin "**ASTEROID ENERGY**" zoteron kuotat në këtë shoqëri si më poshtë:

Alexander Schnell shtetas Austriak, i ditëlindjes 07/01/1972, lindur në Viene, mbajtës i pasaportes nr **U0206852** zoteron 1 kuotë duke përfaqësuar 100% te kapitalit, vendosi të themelojë një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar sipas legjislacionit shqiptar në fuqi dhe në përputhje me të.

zoteron 1 kuotë duke përfaqësuar 100% te kapitalit ku një kuotë ka vlerën **50.000** lekë.

Kapitali eshte 100% i huaj (jo shqiptar)

Kapitali themeltar do të shlyhet plotësisht në para nga Ortaku me themelin e Shoqerisë. Përgjegjësia e ortakëve shtrihet deri në shumën e kontributave në kapitalin themeltar.

NENI 7

Organet Drejtuese

Duke ju referuar ligjit Nr 9901, datë 14/04/2008 "Për tregëtarët dhe Shoqeritë Tregtare", organet drejtuese të shoqerisë janë si më poshtë:

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve - Organi më i lartë vendimarrës.

Administratori - Organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqerisë.

NENI 8

Administratori

Shoqëria administrohet nga Administratori, i cili zgjidhet për një mandat 5-vjeçar me të drejtë rizgjedhje.

NENI 9

Caktimi i Administratorit

Administrator caktohet **Znj Paskualina Gjoni**, shtetase shqiptare, lindur më 16/04/1995 lindur dhe banuese në Shkodër, mbajtës i letërnjoftimit me numër **J55416078W**, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, me një mandat 5 vjeçar dhe ka të drejta totale përfaqësimi te kompanisë.

Afati: 22/03/2024 – 22/03/2029

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administratori, i cili ushton këto të drejta në përputhje me Statutin e Shoqerisë dhe legjislacionin në fuqi.



NENI 10

Ortakët themelues mund të vendosin me vullnetin e tyre për pjesëmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

NENI 11

Organizimi dhe funksionimi i shoqerisë, ngritje e degëve apo filialeve të saj do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe statutit.

NENI 12

Ortakët detyrohen të ruajnë sekretin e themelimit dhe të veprimtarisë së Shoqerisë. Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqerisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhdëmtojnë shoqerinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

NENI 13


Mosmarrëveshjet për themelimin e shoqerisë zgjidhen nga ortakët themelues dhe kur kjo nuk arrihet, ato zgjidhen në Gjykata kompetente.

NENI 14

Akti i themelimit pasi u lexua nga Ortakët Themelues, nënshkruhet pa vërejtje. Ky Akt-Themeli i hartohet në 3 kopje në gjuhën shqipe.

ORTAKËT THEMELUES

Alexander Schnell



Alexander Schnell
MS
07/03/2022



MS
27/03/2022